

Statistikat e transportit

Nëntor 2018

Tiranë, më 27 Dhjetor 2018: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Nëntor 2018 është 317 mijë ton, duke u ulur 7,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2018, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 3.555 mijë ton, duke u ulur me 4,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.628 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 53,8 % krahasuar me Nëntor 2017.

Për njëmbëdhjetëmujorin, ky volum është 17.883 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 25,3 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Nëntor - 2017	341.804	3.522	190
Nëntor - 2018	317.087	1.628	208
Ndryshimi vjetor (%)	-7,2	-53,8	9,5
Janar - Nëntor 2017	3.713.446	23.928	2.047
Janar - Nëntor 2018	3.554.948	17.883	2.014
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-4,3	25,3	-1,6

* Përfshin mallrat dhe postën

Në muajin Nëntor 2018, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 208 ton duke u rritur 9,5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2018, me ajër janë transportuar 2.014 ton mallra duke u ulur 1,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë 2017.

Numri i fluturimeve të kryera, në Nëntor 2018, është 1.780 duke shënuar një ulje me 5,8 %, ndaj Nëntor 2017.

Për publikim 27/12/2017

Në njëmbëdhjetëmujorin 2018, janë kryer 23.532 fluturime, duke u rritur me 5,1 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Nëntor - 2017	19	1.890	9.193
Nëntor - 2018	19	1.780	9.563
Ndryshimi vjetor (%)	-	-5,8	4,0
Janar - Nëntor 2017	19	22.382	157.675
Janar - Nëntor 2018	19	23.532	166.200
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-	5,1	5,4

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Nëntor 2018 është 47.091 pasagjerë, krahasuar me Nëntor 2017, ky tregues është ulur 9,0 %.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2018, kanë udhëtuar me linjë detare 1.444.836 pasagjerë, duke u rritur me 0,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Nëntor 2018, transporti ajror i pasagjerëve zë 79,8 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në njëmbëdhjetëmujorin 2018 është 2.719.911 duke u rritur me 12,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Nëntor - 2017	1.963	51.749	186.164
Nëntor - 2018	4.045	47.091	201.677
Ndryshimi vjetor (%)	106,1	-9,0	8,3
Janar - Nëntor 2017	63.874	1.431.999	2.410.997
Janar - Nëntor 2018	73.476	1.444.836	2.719.911
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	15,0	0,9	12,8

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Nëntor 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 83 mld lekë dhe 50,7 % e tyre u transportua me det.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 870 mld lekë dhe 53,6 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave


Në Nëntor 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 59,7 %, me rrugë 39,6 % dhe me ajër 0,3 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në Nëntor 2018, janë rritur me 16,3 % dhe me det me 2,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 58,9 %, me rrugë 36,4 % dhe me ajër 0,5 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në njëmbëdhjetëmujorin 2018, janë rritur me 16,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës dhe me det me 7,8 %.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2018



Importet e mallrave


Në Nëntor 2018, mallrat e importuara me det zënë 46,3 %, me rrugë 44,9 % dhe me ajër 2,9 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë në Nëntor 2018, janë ulur me 61,2 % dhe me rrugë me 1,8 % krahasuar me Nëntor 2017.

Në njëmbëdhjetëmujorin 2018, mallrat e importuara me det zënë 51,0 %, me rrugë 43,7 % dhe me ajër 2,8 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në njëmbëdhjetëmujorin 2018, janë ulur me 24,2 % dhe me rrugë janë me 7,2 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2018



Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë